REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INTEGRIMIT,POLITIKAVE SOCIALE DHE INFORMIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL DHE KUJDESIT SHËNDETËSOR

Nr. 1889 Prot. Lushnje, më 19/02/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU

"PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E ÇERDHES DHE E KOPËSHTIT PËR FËMIJËT JUSTINA KIPTIU,SOLEN KIPTIU,ELJEN REXHO DHE ESSAMED REXHO"

TË NDERUAR ZONJA DHE ZOTËRINJ KËSHILLTARË!

Në drejtorinë e Shërbimit Social,Njësia për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve ndër rastet e shumta që ka në monitorim,janë familja e Znj.Xhuljeta Korreshi dhe Z.Romeo Kiptiu.

Znj.Xhuljeta është një zonjë me katër fëmijë të mitur dhe në proces divorci, jeton në të njëjtën banesë me prindërit dhe gjyshërit e saj,për arsye se bashkëshorti i saj jeton në emigrim dhe nuk ka qënë i interesuar të kujdeset për fëmijët e tij.

Familja jeton në një shtëpi të vogël me 8 anëtare,në njësinë administrative nr.4.

Nëna e katër fëmijëvë punon në supermarket dhe e ka të vështirë te kujdeset për fëmijët e saj.

Familja ndodhet në kushte të këqija ekonomike dhe në nevojë për mbështetje,përpos kësaj prindërit e zonjës janë të papunë dhe me kemp.

Z.Romeo është babai i katër fëmijëve të mitur që eshtë braktisur nga bashkëshortja prej disa muajsh.I gjendur i vetëm përball këtij fakti Z.Romeo është detyruar të kujdeset vet për fëmijët e tij,gjithashtu edhe të punojë që fëmijëve mos ti mungojë asgjë.

Familja Z.Romeo jeton në një shtëpi të vogël bashkë me familjen e vëllait të tij,në njësinë administrative nr.3.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Familja ndodhet në kushte të këqija ekonomike dhe në nevojë për mbështetje,përpos fëmijët janë në një moshë tepër delikate.

Propozojmë që fëmijët më të vegjël të këtyre familjeje të frekuentojnë çerdhen dhe kopështin pa pagesë.

Mbështetur në Ligjin nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" bazuar në interesin më të lartë të fëmijëve edhe këta fëmijë kanë nevojë për mirëqënie ,të mos ndjehen të distancuar për arsye ekonomike.

Duke marrë parasysh problematikat e këtyre dy familjeve dhe kërkesën e tyre për ndihmë kërkojmë tu vijmë në ndihmë, mbështetur në parimin e interesit më të lartë të fëmijëve për mbështetje emocionale,fizike si edhe të drejtën për arsimim bashkë me bashkëmoshatarët e tjerë.

Në zbatim të:Ligjit Nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës'',Neni 18 pika 1 dhe 2

"E drejta për arsimim";

1- Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe frekuentimit të arsimimit falas e cilësore,në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim,në përputhje me moshën dhe aftësin e tij për të kuptuar.

2- Prindi merr masa të përshtatshme,që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm dhe ose nivele të tjera të arsimimit,sipas dëshirës së fëmijës,si edhe garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.

Ligji Nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës" Neni 20, Pika 3 dhe 4

"E drejta për nivel jetese të përshtatshëm"

1.Çdo fëmijë gëzon të drejten e aksesit në programe për zhvillimin e fëmijërisë së hershme,duke përfshirë aksesin në cerdhe,kopështe ose programe të tjera zhvillim si dhe drejtën e ushqimit gjatë ndjekjes së këtyre programeve sipas standarteve të parashikuara në aktet nënligjore.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

2. Organet e vetëqeverisjes vendore,ministria përgjegjëse në varësi të tyre marrin masat e nevojshme për të ndihmuar prindin ose kujdestarin të ushtrojë këtë të drejtë,në raste se ka nevojë për asistencë materiale dhe programe mbështetëse.

Ju faleminderit!

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Anila Cela

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr 1883/1 Prot Lushnjë më 19/02/2026

PROJEKT – VENDIM
Nr. 25
" PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E ÇERDHES DHE KOPËSHTIT PËR FËMIJËT JUSTINA KIPTIU, SOLEN KIPTIU , ELJEN REXHO DHE ESSAMED REXHO"

Këshilli Bashkiak ne mbledhjen e datës ____/ 02/2026, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, në bazë të nenit 24 pika 1 të ligjit nr.139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar. Neni 18 pika 1 dhe 2, neni 20 pika 3 dhe 4 si dhe Konventës për të drejtat e femijës ju:

PROPOZOJMË:

1. Përjashtimin nga pagesa e çerdhes fëmijët Solen Romeo Kiptiu dhe Eljen Nail Rexho.
2. Përjashtimin nga pagesa e kopështit fëmijët Justina Romeo Kiptiu dhe Essamed Nail Rexho.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qëndra e Arsimit , Bashkia Lushnjë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
Anila Çela

DREJTORIA JURIDIKE
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com